

## **Faqe informacioni për përpunimin e të dhënave sipas neneve 13, 14 të Urdhëresës themelore për mbrojtjen e të dhënave (DSVGO) për pjesëmarrëset dhe pjesëmarrësit në kursin e integritimit**

Kursi i integritimit koordinohet dhe kryhet nga Enti Federal për Migracion dhe Refugjatë, i cili përdor për këtë mbartës privatë dhe publikë të kursit, neni 43, par. 3 fjalia 2 AufenthG [Ligji për qëndrim].

Për përmbushjen e kësaj detyre do të mblidhen dhe përpunohen të dhënat tuaja në lidhje me personin nga vendet e mëposhtme:

- Enti Federal mbledh të dhënat tuaja në lidhje me personin, derisa kjo është e nevojshme për qëllimet e mëposhtme:
  - Lejimin për pjesëmarrjen në një kurs integrimi (neni 5, par. 1 IntV [Urdhëresa për kurset e integritimit] dhe për përsëritjen prej maksimumi 300 orësh mësimi të kursit të gjuhës (neni 5, par. 5 IntV).
  - Lirim nga kontributi për kostot e kursit të integritimit (neni 9, par. 2 IntV)
  - Sigurimi i një shtese për kostot e udhëtimit (neni 4a, par. 1 IntV)
  - Rikthim prej 50 % i kontributit për kostot e kursit të integritimit (neni 9, par. 6 IntV)
- Përderisa autoritetet për të huajt, mbartësi i sigurimit bazë për kërkues pune, mbartësi i pagesave sipas ligjit për pagesat e azilkërkuesve ose Enti i Administratës Federale japin për ju një të drejtë ose detyrim për pjesëmarrjen në kurs, i dërgojnë këto vende Entit Federal të dhënat tuaja në lidhje me personin, në veçanti të dhënat e vërtetimit të drejtës së pjesëmarrjes dhe të dhënat për çuarjen në një vend testimi ose regjistrimi. Transmetimi i të dhënave për tek Enti Federal pason, derisa kjo është e nevojshme në veçanti për llogaritjen dhe kryerjen e kurseve të integritimit (neni 88a, par. 1, fjalia 1 AufenthG [Ligji për qëndrim]).
- Derisa Enti Federal, sipas nenit 7, par 3 ose 5 IntV, ju përcakton juve një mbartës të caktuar kursi ose iu çon në një mbartës të caktuar kursi për qëllime të pjesëmarrjes brenda një kohe të shkurtër në kurs, Enti Federal informon për këtë mbartësin e kursit si dhe (derisa kjo vlen për ju) vendin, i cili ju ka detyruar për pjesëmarrjen në kurs.
- Mbartësi i kursit i transmeton Entit Federal të dhënat e regjistrimit tuaj në kursin e integritimit dhe pjesëmarrjen tuaj në kursin e integritimit, përderisa kjo është e nevojshme për verifikimin e pjesëmarrjes sipas rregullit, për lëshimin e vërtetimit të pjesëmarrjes me sukses respektivisht pa sukses në kursin e integritimit ose për llogaritjen dhe kryerjen e kursit të integritimit (neni 88a, par. 1 fjalia 1 AufenthG).
- Përderisa ju shfrytëzoni një përkujdesje shoqëruese për fëmijët gjatë kursit të integritimit sipas nenit 4 a par. 2 IntV, institucioni i përkujdesjes ruan mbiemrin, emrin

dhe datëlindjen e fëmijës, për të cilin do të kujdeset. Këto të dhëna do të transmetohen nga mbartësi i kursit për tek BAMF-i për qëllime të miratimit dhe llogaritjes.

- Derisa ju jeni të detyruar për pjesëmarrjen në kursin e integritit, mbartësi i kursit informon vendin/vendet i cili/të cilët kanë dhënë këtë detyrim, nëse ju nuk merrni pjesë sipas rregullit në kursin e integritit (neni 88a, par. 1 fjalia 2 AufenthG).
- Me kërkesë, Enti Federal i transmeton të dhënat tuaja në lidhje me personin tek autoriteti përgjegjës për të huajt, mbartësi përgjegjës për sigurimin bazë për kërkues pune ose mbartësi përgjegjës i pagesave sipas ligjit për pagesat e azilkërkuesve, derisa kjo është e nevojshme në veçanti për dhënien e një lejimi, të drejte ose detyrimi në kursin e integritit, për kontrollimin e përmbushjes së detyrimit për pjesëmarrje dhe për zgjatjen e një leje qëndrimi (neni 88a, par. 1 fjalia 3 AufenthG).

Enti Federal është përgjegjës për mbrojtjen dhe për sigurinë e të dhënave tuaja në lidhje me personin, të cilat Enti Federal i mbledh vetë ose i ka marrë nga vende të tjera.

Të dhënat e kontaktit të Entit Federal janë:

Bundesamt für Migration und Flüchtlinge  
Frankenstraße 210  
90461 Nürnberg

Të dhënat e kontaktit të të ngarkuarit me mbrojtjen e të dhënave të Entit Federal janë:

Bundesamt für Migration und Flüchtlinge  
- Behördlicher Datenschutzbeauftragter -  
Frankenstraße 210  
90461 Nürnberg

Mbiemri, emri dhe datëlindja juaj do të fshihen më së voni dhjetë vjet, të dhënat tuaja të tjera në lidhje me personin më së voni pesë vjet pas përfundimit të kursit të integritit (neni 8, par. 6 IntV).

Ju keni të drejtën të bëni kërkesë tek Enti Federal që të kufizohet përpunimi i të dhënave tuaja në lidhje me personin, nëse ju bëni të besueshme, se interesat tuaja me denjësi mbrojtjeje ose interesat me denjësi mbrojtjeje të të tjerëve do të kufizohen nëpërmjet përpunimit të të dhënave. Një përpunim i tyre pason vetëm atëherë, përderisa qëndron një interes publik mbizotërues për këtë. Më tej ju keni të drejtën mbi informacion dhe korrigjim në lidhje me të dhënat tuaja në lidhje me personin dhe të drejtën e fshirjes së të dhënave tuaja për rastin, që këto u përpunuan në mënyrë të padrejtë.

Përveç kësaj ju keni të drejtën e ankesës tek autoriteti mbikëqyrës përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave:

Bundesbeauftragte für den Datenschutz und die Informationsfreiheit  
Graurheindorfer Straße 153  
53117 Bonn